



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:097194

Datë: 01.03.2024

Numri i dokumentit: 05399119

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr../..

GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL, me gjyqtarin e vetëm gjykues Musë Povataj, me pjesëmarrjen të bashkëpunëtores profesionale Edona Berisha Kastrati, në çështjen penale ndaj të pandehurit, L.. Z.. për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 nënpar.1.4 të KPRK-së, i akuzuar nga Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti për Krime të Përgjithshme sipas aktakuzës PP/II nr. 642/23 të datës 25.04.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 12.02.2024 ët mbyllur për publikun, në prezencë të Prokurores së Shtetit Ardiana Veseli, të pandehurit L.. Z.. dhe të dëmtuarit L.. Z.. dhe mbrojtësi i viktimave Luan Mehetaj, me datë 14.02.2024 bie dhe shpall publikisht, ndërsa me datë 01.03.2024 përpilon këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri,

L.. Z., i lindur me, në fsh. J.. e madhe K. P., tanimë me vendbanim *në fsh. B... K. P.. rr. P.. G..*, nga babai S., e nëna F., e gjinisë L., ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i pa martuar, me gjendje të mesme ekonomike, posedon letërnjoftim me nr., posedon telefon, Shqiptarë, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në liri,

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Me dt. 01.04.2023, rreth orës 23:20, në fsh. B... K. P., pikërisht në shtëpinë e tij, brenda marrëdhënies familjare, me dashje i shkakton lëndime të lehta trupore të dëmtuarit L.. Z.- të cilin e ka djalë, në atë mënyrë që, natën kritike pas një mosmarrëveshje që kishin pasur në mes vete lidhur me atë se sipas të pandehurit L.. nuk ishte kujdes për bagëtinë, i pandehuri fillimisht i drejtohet të dëmtuarit me fjalët *“qysh ja ke qitë terezinë, ti mu end nëpër Pejë posht e përpyetë, e unë me ta pagu kredinë”*, e pastaj e kap për qafe duke e shtrënguar me duar dhe e godet me grushta në kokë, me ç’rast i dëmtuari ka pësuar lëndime trupore,

Me çfarë ka ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 nënpar.1.4 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve: 7, 17, 21, 38, 48, 49, 69,70 dhe nenit 185 të KPRK-së, si dhe nenit 242 dhe 364 të KPPRK-së, të pandehurit L.. Z.. i shqipton:

DËNIM TË KUSHTËZUAR

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muaj, të cilin dënim i pandehuri nuk do të ta mbaj në rast se i njëjti në afat prej 1 (një) vite nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Dënimi me kusht do të mbikëqyret nga shërbimi provues. **URDHËROHET** i pandehuri L.. Z.. që të mbaj kontaktin me shërbimin provues në Pejë dhe i njëjti njoftohet nëse i shkëput kontaktet me shërbimin provues, gjykata mund të revokoj dënimin me kusht.

I pandehuri obligohet që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumë prej 40,00 € në afat prej 15 ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

I dëmtuari L.. Z.. me vendbanim në fsh. *në fsh. B.. K. P.. rr. P.. G.. ka hequr nga kërkesa pasurore juridike.*

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë PP/II nr. 642/23 të datës 25.04.2023, ndaj të pandehurit L.. Z.. për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 nënpar.1.4 të KPRK-së

Në shqyrtimin fillestar të datës 12.02.2024 gjykata në pajtim me nenin 241 par. 1 të KPPRK-së e ka udhëzuar të pandehurin L..Z.. për të drejtën e tij për të mos u deklaruar në çështjen e tij ose të mos përgjigjet në pyetje dhe nëse ai deklarohej për çështjen, se nuk kanë për detyrë të inkriminojë vetveten ose të afërmit, as të pranojë fajësinë, të mbrohet vetë ose nëpërmjet ndihmës juridike nga mbrojtësi sipas zgjedhjes së tij, të kundërshtojnë aktakuzën dhe pranueshmërinë e provave të paraqitura në aktakuzë.

Pasi i pandehurit L.. Z.. ka hequr dorë nga e drejta e leximit të aktakuzës gjykata është bindur se i pandehurit e ka kuptuar aktakuzën dhe nuk ka nevojë për sqarime shtesë. Më pas gjykata e ka njoftuar të pandehurin për pasojat dhe benefitet e pranimit të fajësisë.

I pandehuri L.. Z.. është deklaruar fajtorë për veprën penale sipas aktakuzës duke deklaruar se: e pranoj fajësinë për veprat penale sipas aktakuzës, të dëmtuarin e kam djall dhe raportet i kemi shumë të mira.

Ne vlerësimin e pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit gjykata ka kërkuar mendimin nga ana e Prokurorit të Shtetit i cili ka deklaruar se: pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit. Pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare nga ana e të pandehurit e po ashtu gjënë mbështetje edhe në shkresat e lëndës.

Mbrojtësi i viktimave lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar: pajtohem me pranimin fajësisë nga ana te pandehurit.

I dëmtuari L.. Z.. lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar,: pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, nuk kërkoj kompensim demi dhe nuk i bashkëngjitem ndjekjes penale.

Gjyqtari i vetëm gjykues është bindur se ne seancën e shqyrtimit fillestar nuk ekzistojnë rrethana për hedhjen e aktakuzës nga neni 248 par. 1 pika 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të KPPRK-se, si dhe janë vërtetuar faktet nga neni 242 par. 4 të KPRK-së, ngase aktakuza mbështet në këto prova siç janë raporti i policit F..E.. i përpiluar me dt. 02.04.2023; raporti mjekësor me numër protokollit 5668 i lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm në Pejë më datë 01.04.2023; raporti policor i dërguar përmes email-it nga zyrtari policor F.. I.. më datë 02.04.2023; deklarata e të dëmtuarit e dhënë në polici më dt. 02.04.2022; deklarata e të pandehurit e dhënë në polici më dt. 02.04.2023; akt ekspertimi mjeko- ligjor dt. 13.04.2023 i kryer nga Dr. F.. D.., andaj ka marr aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehurit.

Andaj me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit i cili mbështet në provat në bazë të së cilave bazohet aktakuza është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale nga neni 185 par 1 npn apr. 1.4 të KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurit dhe i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit dhe masës , gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 70 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin, gjykata mori pranimin e fajësisë, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata ka gjetur faktin se vepra penal është kryer brenda marrëdhënies familjare.

Gjyqtari i vetëm gjykues ka vlerësuar se me dënimin e shqiptuar si ne dispozitiv te këtij *aktgjykimi, duke i tërhequr e* vërejtjen me kërcënimin e dënimit mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar në nenin 449 të KPPRK-së, e obligoi të akuzuarin që ti paguaj shpenzimet për paushall gjyqësor në shumë prej 20,00 €, e duke u bazuar ne shpenzimet që janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri ne përfundimin e saj dhe 20,00 € për taksen për programin për kompensimin e viktimave të krimit,

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa komfor nenit 369 të KPPRK-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL
2023:097194, 01.03.2024**

Bashkëpunëtorja Profesionale

Edona Berisha Kastrati

G j y q t a r i,

Musë POVATAJ

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë ditëve) ditëve nga koha e pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.